

Bursat ndërkombëtare dhe programet e mobiliteteve të financuara dhe/ose administruara nga divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar në arsim të lartë dhe shkencë

Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare (CEEPUS)

Qëllimi i këtij programi shumëpalësh universitar është të mbështesë shkëmbimin akademik në fushën e arsimit dhe zhvillimit profesional për studentët dhe stafin akademik në Evropën Qendrore dhe Lindore. CEEPUS ofron mundësi mobiliteti për studentët BA/MA, studentët e doktoraturës dhe stafin akademik të lidhur me universitetet/kolegjet e akredituara dhe të licencuara në Republikën e Kosovës. Studentët dhe stafi, universiteti/fakulteti i të cilëve është anëtar i një rrjeti bashkëpunimi të themeluar nga CEEPUS, mund të aplikojnë brenda këtij rrjeti. Nëse Universiteti/Fakulteti i një aplikanti nuk është anëtar i një rrjeti bashkëpunimi CEEPUS, aplikanti mund të aplikojë si një “free mover”.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim: <https://www.ceepus.info/>

ERASMUS +

“Erasmus+ është program i Bashkimit Evropian për të mbështetur arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në Evropë.” Erasmus+ mbështet një sërë programesh të ndryshme financimi, duke përfshirë bursa, mobilitete dhe trajnime për studentët si dhe mundësi mësimdhënieje dhe trajnimi për stafin akademik (Veprimi kyç 1). Për institucionet (Veprimi kyç 2), “projektet e ngritjes së kapaciteteve në fushën e arsimit të lartë janë projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar, të bazuara në partneritete shumëpalëshe”. Disa nga këto programe janë theksuar më poshtë.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim: <https://erasmuspluskosovo.org/>

Për studentë, Erasmus + ofron programin “International Credit Mobility” për studentët e nivelit Bachelor dhe Master për të studiuar jashtë vendit nga 3 deri në 12 muaj. Erasmus + ofron gjithashtu programin “Traineeships” (Punë praktike) për studentët të cilët dëshirojnë të fitojnë përvoja praktike jashtë vendit.

Për stafin, Erasmus+ ofron mundësi për mësimdhënie në një institucion arsimor jashtë vendit. Këto mundësi janë të disponueshme si për stafin që punon në sektorin e arsimit ashtu edhe për individët e bizneseve të ftuara për të ndarë njohuritë e tyre për një sektor, lëndë ose temë të caktuar me studentët. Mundësitë për të dhënë mësim jashtë vendit përmes programit Erasmus+ janë të disponueshme për institucionet arsimore që veprojnë në të gjitha nivelet. Mundësitë e trajnimit janë të disponueshme për stafin që punon në arsim, si për mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës.

Periudhat e trajnimit jashtë vendit mund të përbëhen nga periudha vëzhgimi në vendin e punës, kurse të zhvillimit profesional ose ngjarje specifike për ndërtimin e kompetencave. Erasmus+ mbështet trajnimin si në institucionet arsimore ashtu edhe në organizatat përkatëse që veprojnë jashtë këtij sektori. Mundësitë për të marrë pjesë në aktivitetet e zhvillimit profesional janë në dispozicion të stafit që punojnë në të gjitha nivelet e arsimit.”

Diplomë Master e Përbashkët Erasmus Mundus (EMJMD)

Diploma e Përbashkët Master “Erasmus Mundus” (EMJMD) është një program studimi ndërkombëtar prestigjioz, i integruar, i ofruar bashkërisht nga një konsorcium ndërkombëtar i institucioneve të arsimit të lartë. Studimi duhet të zhvillohet në të paktën dy nga vendet e programit. Përfundimi me sukses i programit të studimit do të çojë në dhënien e një diplome të përbashkët (dmth. një diplomë e vetme e lëshuar në emër të të paktën dy institucioneve të arsimit të lartë të konsorciumit EMJMD) ose diploma të shumëfishta (dmth. të paktën dy certifikata të lëshuara nga dy institucione të arsimit të lartë të konsorciumit). Bursa EMJMD, mbulon kostot e pjesëmarrjes së studentëve (duke përfshirë tarifat e shkollimit, mbulimin e plotë të sigurimit dhe çdo kosto tjetër të detyrueshme në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve në nivelin Master); ajo përfaqëson një kontribut në kostot e udhëtimit dhe akomodimit të studentëve dhe përfshin një kompensim mujor për jetesën për të gjithë kohëzgjatjen e programit të studimit EMJMD.”

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim: <https://erasmuspluskosovo.org/en/students/degree-mobility/open-calls/>

Jean Monnet Veprimet

Veprimet Jean Monnet “mbështesin mësimdhënien, mësimin, kërkimin dhe debatet mbi aspekte të ndryshme të Bashkimit Evropian”. Qëllimi i këtyre programeve është “të mbështesë mësuesit në arsimin fillor, të mesëm dhe profesional për të informuar të rinjtë dhe për të zhvilluar ndërgjegjësimin kritik për Bashkimin Evropian, çfarë është ai, si funksionon dhe çfarë ndryshimi bën në jetën e tyre të përditshme. Këto veprime mbulojnë arsimin dhe trajnimin profesional (ISCED 1-4).”

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim: <https://erasmuspluskosovo.org/en/organizations/higher-education-institutions/jean-monnet/how-to-apply/>

Programi Fulbright

Programi Fulbright është programi kryesor ndërkombëtar i shkëmbimit arsimor i sponsorizuar nga qeveria amerikane dhe është krijuar për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellë midis njerëzve të

Shteteve të Bashkuara dhe njerëzve të vendeve të tjera. Institucionet e Kosovës kanë qenë të përfshira në Programin Fulbright për shumë vite. Republika e Kosovës e ka zyrtarizuar këtë marrëdhënie me një Memorandum Mirëkuptimi (MOU) në vitin 2012, duke e përtërirë më vonë. Memorandumi i Mirëkuptimit ka rezultuar në një marrëdhënie të zgjeruar me programin Fulbright, të bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës, i cili ka çuar në rritjen e mundësive për studentët dhe stafin akademik të Kosovës.

Memorandumi i fundit i Mirëkuptimit (MOU) ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës (MASHTI) dhe Ambasada e SHBA-së në Kosovë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53749>

Bordi i Shkëmbimit Arsimor- Shtetet e Bashkuara-Kosovë (USKEB) është një bord këshillues jo juridik, i themeluar me qëllim të rritjes së mirëkuptimit të ndërsjellë dhe avancimit të marrëdhënieve midis popullit të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës përmes programeve të shkëmbimit arsimor. USKEB, u formua për të këshilluar dhe ndihmuar në priorizimin e burimeve dhe përcaktimin e prioriteteve për programet e shkëmbimit arsimor Shtetet e Bashkuara-Kosovë, duke përfshirë programin Fulbright për Kosovën dhe mbështetet nga Zyra e Departamentit të Shtetit për Çështjet Arsimore dhe Kulturore (ECA) në SHBA, Ambasada e SHBA në Kosovë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës. USKEB zbatohet nga Këshilli Amerikan.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim: <https://www.uskeb.org/>

Programi Fulbright për zhvillimin e stafit akademik

Qëllimi i programit është të prezantojë pjesëmarrësit me praktikën më të mira dhe qasjet teorike për zhvillimin e kurrikulës në SHBA dhe t'u ofrojë atyre strategji konkrete se si të zhvillojnë kurrikulën për një lëndë, duke përfshirë një pasqyrë të burimeve akademike dhe kërkimore.” Ky program mbështet stafin akademik që aktualisht jep mësim në Kosovë. “Ky program financohet bashkërisht nga Zyra e Departamentit të Shtetit SHBA dhe Qeveria e Kosovës.”

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim: <https://xk.usembassy.gov/fulbright-faculty-development-program/>

Programi Fulbright për studiues vizitues

The Fulbright Visiting Scholar Program, është një program post-doktoral për studiuesit e rinj dhe me përvojë, ligjërues universitarë dhe ekspertë nga institucionet akademike në Kosovë, të cilët dëshirojnë të zhvillojnë kërkime të avancuara dhe ligjërata universitare në Shtetet e Bashkuara. Kohëzgjatja e programit është nga tre deri në nëntë muaj. Ky program financohet bashkërisht nga Zyra e Departamentit të Shtetit SHBA dhe Qeveria e Kosovës.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:
<https://xk.usembassy.gov/education-culture/exchange-programs/fulbright-scholar-program/>

Programi Fulbright për studentë të huaj

Programi Fulbright për studentë të huaj sjell studentë nga vende të tjera në Shtetet e Bashkuara për të studiuar në nivelin Master në universitetet amerikane. Ky program financohet bashkërisht nga Zyra e Departamentit të Shtetit të SHBA dhe Qeveria e Kosovës.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:
<https://xk.usembassy.gov/education-culture/exchange-programs/fulbright-foreign-student-program-masters-degree/>

Programi Fulbright Specialist

Programi Fulbright Specialist (FSP) i lejon institucionet pritëse të Kosovës të sjellin studiues dhe profesionistë të kualifikuar amerikanë në Kosovë për dy deri në gjashtë javë për të përfunduar një projekt të caktuar. Ky është një program i përbashkët i Zyrës së Departamentit të Shtetit të SHBA dhe Qeverisë së Kosovës.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:
https://xk.usembassy.gov/fulbright_specialist/

Projekti HERAS+

Qëllimi i projektit HERAS+ është të kontribuojë në një sektor më konkurrues dhe të larmishëm të arsimit të lartë publik dhe kërkimit në Kosovë. Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fonde nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës (MASHTI). HERAS+ mbështet një sërë programesh të ndryshme financimi, duke përfshirë bursat për studentët e doktoratës dhe hulumtuesit post-doktoral. Qëllimi i këtij programi është që studentët e doktoraturës dhe hulumtuesit post-doktoral do të kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve institucionale të institucioneve të tyre në Kosovë, duke përfunduar studimet e doktoraturës dhe kërkimet post-doktorale në një institucion në Austri.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:
<https://www.heraskosovo.org/>

Bursa e Qeverisë Japoneze (MEXT)

Ministria e Arsimit, Kulturës, Sportit, Shkencës dhe Teknologjisë e Japonisë (Monbukagakusho: MEXT) ofron një numër të programeve të ndryshme të bursave për studentët e Kosovës. Këto përfshijnë: Bursa për studentët e Kolegjit të Trajnimit të Specializuar, bursa për studentët e Kolegjit të Teknologjisë (KOSEN) (Shkolla e Mesme Teknologjike), Bursa për studentët universitarë dhe bursa për studentët hulumtues.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim

https://www.ks.emb-japan.go.jp/itpr_en/culture.html

Bursat e bashkëfinancuara me ambasadën e Francës në Kosovë

MASHTI në bashkëpunim me Ambasadë e Francës në Kosovë ofron bursa universitare të nivelit Master për studentët kosovarë që dëshirojnë të studiojnë në Francë.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linqet në vazhdim:

<https://kosovo.ambafrance.org/-Etudier-en-France-311->

dhe

<https://kosovo.ambafrance.org/Thirrje-per-aplikim-bursa-universitare-ne-France-2057>

Fondi Kosovar Amerikan për Edukim (KAEF)

Fondi Kosovar Amerikan për Edukim (KAEF), i dedikohet zhvillimit ekonomik afatgjatë të Kosovës nëpërmjet edukimit të popullit të saj. KAEF ofron deri në 8 bursa të nivelit master në vit për kosovarë të talentuar, që të studiojnë në universitetet më prestigjioze në SHBA. Pas kthimit në Kosovë, bursistët KAEF marrin pozita udhëheqëse në sektorët publik dhe privat të vendit, duke përdorur njohuritë e tyre dhe aftësitë e arritura për të gjeneruar ndryshime të qëndrueshme dhe pozitive. Bursat e KAEF, jepen përmes një konkursi të bazuar në merita. Studentët studiojnë në programet e nivelit master për një ose dy vjet, diplomojnë dhe bëhen një forcë e rëndësishme për Kosovën. Financimi përfshin mbështetjen për shkollimin, një pagesë modeste jetese, sigurim mjekësor, një kompensim për libra dhe udhëtime ndërkombëtare.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:

<https://www.kaef-online.org/>

Programi "Stipendium Hungaricum"

Programi Stipendium Hungaricum, programi më prestigjioz i bursave të arsimit të lartë të Qeverisë Hungareze, u krijua për të promovuar ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë hungarez dhe për të tërhequr studentë më të dalluar ndërkombëtarë nga e gjithë bota. Studentët mund të marrin pjesë në programet Bachelor, Master, Doktoraturë ose post-doktoratë. Bursa përfshin shkollimin, akomodimin, sigurimin shëndetësor dhe një pagë mujore jetese.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:

<https://stipendiumhungaricum.hu/>

Programi “Young Cell Scheme”

Programi “Young Cell Scheme”, është një program bursash, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe nga Qeveria e Kosovës, i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe i zbatuar nga Konsorciumi i Universitetit Aristotel të Selanikut dhe Instituti Kombëtar i Shërbimit Publik, Francë. E lansuar në vitin 2004, kjo skemë ofron një mundësi për studentët e rinj kosovarë nga drejtime të ndryshme për të studiuar në universitetet më të mira në Shtetet Anëtare të BE-së me qëllim për të tërhequr në mënyrë sistematike kandidatët e rinj për shërbimin civil për një periudhë prej tre vite radhazi, pas përfundimit me sukses të studimeve të tyre. Objektivi i përgjithshëm i YCS është forcimi i kapaciteteve profesionale të shërbimit civil në afat të gjatë për t’i shërbyer më mirë qytetarëve të Kosovës dhe për të përmbushur detyrimet dhe kërkesat që rrjedhin nga procesi i integritit të vendit në BE. Në përputhje me standardet më të mira të BE-së, programi i bursave YCS ndihmon Kosovën të gjenerojë një administratë publike të depolitizuar, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe efektive, të aftë për të zbatuar legjislacionin e BE-së dhe ofron një politikë më të mirë të menaxhimit të karrierës. Mbështetja financiare përfshin kostot e plota të shkollimit, shpenzimet e jetesës, transportin për në vendin e studimit nga vendbanimi dhe kthimin, si dhe mbulimin e punës praktike në institucionet e Qeverisë së Kosovës.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linkun në vazhdim:
<https://yckosovo.org/index.php/en/>

Programet ndërkombëtare të financimit të financuara dhe/ose administruara nga divizioni për bashkëpunim ndërkombëtar në arsim të lartë dhe shkencë

Programi për Bashkëpunimin Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST)

Programi i Bashkëpunimit Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST), ofron qasje kritike në rrjetet unike të kërkimit ndërdisiplinor që përfshijnë studiues, novatorë dhe profesionistë të tjerë (p.sh. specialistë të industrisë) që punojnë në Evropë si dhe më gjerë. Veprimet COST përfshijnë: Misionet shkencore afatshkurtra, shkollat e trajnimit, aktivitetet e komunikimit dhe mjetet e rrjetëzimit virtual. Veprimet 4-vjeçare COST mbështesin shpenzimet që lidhen me ngjarjet e rrjetëzimit, në krahasim me shpenzimet e kërkimit. Duke financuar rrjetëzimin, COST vepron si një paraportal për financimin e mëtejshëm të kërkimit dhe inovacionit si Horizon Europe. Veprimet COST janë unike dhe të ndryshme nga shumë programe të tjera të financimit të BE-së në atë që të mundëson të bashkohesh me një rrjet ekzistues të kërkimit COST Action pasi të ketë filluar tashmë, edhe nëse hulumtuesi nuk ishte i përfshirë në paraqitjen fillestare të propozimit. Hulumtuesit më pas mund të marrin pjesë në seminare, konferenca, trajnime dhe mundësi të tjera të ofruara nga ai COST Action. Hulumtuesit gjithashtu mund të ndjekin një aksion të tyre COST

duke paraqitur një propozim gjatë një thirrje të hapur nga COST. Kosova iu bashkua COST-it në vitin 2018 si një “Vend fqinj i bashkëpunimit”.

Për më shumë informacione në lidhje me programin dhe aplikimin kliko në linqet në vazhdim:
<https://www.cost.eu/>

Horizon Europe

“Horizon Europe, është programi kryesor i financimit të BE-së për kërkimin dhe inovacionin me një buxhet prej 95.5 miliardë euro. Programi lehtëson bashkëpunimin dhe forcon ndikimin e kërkimit dhe inovacionit në zhvillimin, mbështetjen dhe zbatimin e politikave të BE-së gjatë trajtimit të sfidave globale. Programi po ashtu mbështet krijimin dhe shpërndarjen më të mirë të njohurive dhe teknologjive të shkëlqyera. Ai krijon vende pune, angazhon plotësisht grupin e talenteve të BE-së, nxit rritjen ekonomike, promovon konkurrencën industriale dhe optimizon ndikimin e investimeve në forcimin e Zonës Evropiane të Kërkimit.

https://research-and-innovation.ec.europa.eu/funding/funding-opportunities/funding-programmes-and-open-calls/horizon-europe_en

<https://kosovoncp.rks-gov.net/>

Kosova ka marrë pjesë në Programet Kornizë të Kërkimit dhe Inovacionit të BE-së që nga viti 2007, duke filluar me “Programin e shtatë kornizë (FP7)”. Pjesëmarrja e Kosovës si një nga vendet partnere të bashkëpunimit ndërkombëtar (ICPC) rezultoi në 23 aplikime me 3 projekte të fituara, në total 344.135,44 euro. Shkalla e suksesit të Kosovës në FP7 ishte 17,86%. Norma mesatare e suksesit të vendeve të ICPC ishte 22.09 %.

Kosova më pas mori pjesë në programin pasues Horizon 2020, gjithashtu si një vend ICPC, me një nivel të rritur pjesëmarrjeje dhe një numër dukshëm më të madh të projekteve të financuara. Kosova u paraqit me 113 aplikime, me 21 projekte të fituara. Shkalla e suksesit të Kosovës ishte 20.01%, mbi normën mesatare të suksesit të vendeve të ICPC, e cila ishte 18%. Kosova në këtë program ka përfituar me projekte në vlerën prej 2.555.857,00 euro.

Në janar të vitit 2021, Kosova u bë anëtare plotësisht e asociuar në programin Horizon Europe, duke mundësuar që kërkuesit, novatorët dhe entitetet kërkimore të Kosovës të marrin pjesë në të njëjtat kushte si entitetet nga shtetet anëtare të BE-së. Ky është një zhvillim shumë pozitiv që ka mundësuar rritjen e bashkëpunimit midis Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së, si dhe vendeve të tjera pjesëmarrëse në Horizon Europe. Linku i marrëveshjes për statusin e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në programin Horizon Europe:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53720>

Të jeni të informuar se: Përveç programeve të përshkruara më lartë, ambasadat e huaja në Kosovë mund të ofrojnë bursa dhe programe mobiliteti shtesë, të cilat nuk administrohen ose bashkëfinancohen nga MASHTI. Të interesuarit inkurajohen të vizitojnë faqet e internetit të këtyre Ambasadave (p.sh. Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Turqi, etj.) si dhe t'i kontaktojnë ato për informacione të mëtejshme.